



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJ
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE**

Informacion mbi aktivitetin e planifikuar në projektin:

“Integrimi ndërdisiplinor i kërkimit shkencor në fushën e mësimdhënies së gjuhëve të huaja - rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore”

Në datën 23 nëntor 2023, u zhvillua me sukses trajnimi i parë me studentët e programit të studimit “Mastër në mësuesi”, të Departamentit të Gjuhës Gjermane në kuadër të projektit "Integrimi Ndërdisiplinor i Kërkimit Shkencor në Fushën e Mësimdhënies së Gjuhëve të Huaja - Rritja e Kapaciteteve Kërkimore Shkencore", i financuar nga Universiteti i Tiranës.

Trajnimi u drejtua nga grupi i punës i projektit, përbërë nga Ema Kristo, Jonida Bushi dhe Marsela Likaj.

Gjatë këtij trajnimi, u trajtua me thellësi fusha e kërkimit shkencor në lidhje me mësimdhënien e gjuhëve të huaja. Diskutimet u përqëndruan në metodat e kërkimit më efikase dhe në hartimin e punimeve shkencore. Pjesëmarrësit u njohën me shembuj konkretë të hartimit të punimeve shkencore dhe morën njohuri të reja që do të pasurojnë praktikën e tyre mësimore.

Trajnimi u përqëndrua në disa tema kyçe që u shtruan dhe u diskutuan për të thelluar konceptin e integritetit të kërkimit shkencor në mësimdhënie.

Temat konkrete që u trajtuan gjatë trajnimit u fokusuan në:

- Metodologjitë e kërkimit shkencor në mësimdhënie: Diskutimet u përqëndruan në metodat më të përshtatshme për të integruar kërkimin shkencor në mësimdhënie. U shqyrtuan metodologjitë që inkurajojnë studentët të shfrytëzojnë burimet e disponueshme dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre kritike në analizën e informacionit.
- Përdorimi i rezultateve të kërkimit shkencor në mësimin e gjuhëve të huaja.
- Pjesëmarrja e studentëve në kërkimin shkencor: u zhvilluan diskutime konkrete rreth mënyrave se si mund të inkurajohet pjesëmarrja aktive e studentëve në kërkimin shkencor. U prezantua pse është e rëndësishme që ata të kenë një rol aktiv në përgatitjen dhe zhvillimin e punimeve shkencore.
- Aftësitë kritike dhe analitike të studentëve: Trajnimi u përqëndrua gjithashtu në metodat që ndihmojnë në përmirësimin e aftësive kritike dhe analitike të studentëve. Diskutimet u përqëndruan në faktin se si kërkimi shkencor mund të ndihmojë në formimin e tyre për të shqyrtuar dhe vlerësuar me në mënyrë kritike informacionin.

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit u inkurajuan të vazhdojnë hulumtimin dhe të aplikojnë njohuritë e fituara nga ky trajnimi i parë në projektet e tyre individuale. Grupi i punës po vazhdon përpjekjet për të identifikuar dhe zhvilluar trajnime konkrete në këtë fushë, duke përdorur njohuritë e fituara gjatë trajnimit. Ky aktivitet shënon fillimin e një periudhe intensive të përmirësimit dhe zhvillimit të kapaciteteve kërkimore për pjesëmarrësit në projekt.

Foto të aktivitetit

